

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË-DEPARTAMENTI I PËRGJTHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.N. nga fshati e Epërme, komuna e Shtërpcës dhe M.S. nga Gjilani, rr.””, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1383-4/14 dt.12.11.2014, përshkak të veprës penale në bashkëkryerje legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit publik për pranimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, në prani të përfaqësuesit të akuzës-Prokurorit të Shtetit Veton Shabani, të akuzuarve M.N. dhe M.S. si dhe mbrojtësve të tyre të caktuar sipas detyrës zyrtare av.M.P. dhe av.V.J., me dt.19.05.2016 mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.I akuzuari M.N. nga fshati e Epërme, komuna e Shtërpcës, data e lindjes....., në, nga i ati Z. dhe e ëma J., e gjinisë K., serb, shtetas i Republikës së Kosovës, apsolvent i fakultetit juridik, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike.

2.I akuzuari M.S. nga Gjilani, rr.”....., data e lindjes....., në, nga i ati Z. dhe e ëma T., e gjinisë Rr., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion teneqe punues, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike

JANË FAJTORË

Sepse me datën 16.02.2012 në Qendrën e Regjistrimit të automjeteve-QRA në Shtërpcë, pas një marrëveshje paraprake kanë vënë në lajthim organin kompetent për të vërtetuar një çështje të pavërtetë e paraparë të shërbej si provë në një dokument publik, në atë mënyrë që me qëllim që ti ikin zhdoganimit dhe regjistrimit të rregullt të automjetit të markës “Ford Mondeo” me numër të shasisë i vitit të prodhimit 1997, përmes dokumentit të falsifikuar librezës së qarkullimit nr..... të shtetit të serbisë në emër të të pandehurit M.N. të cilin ia kishte siguruar i pandehuri M.N., kanë arritur që të regjistrojnë automjetin në QRA në Shtërpcë të cilin automjet e ka shfrytëzuar i pandehuri i dytë edhe pse e ka ditur se të njëjtat dokumente janë të falsifikuara.

Me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Andaj në bazë të neneve 6, 11, 34, 38 par.3, 39, 41, 42, 43, 44 dhe 64 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarit i

G J Y K O N

- I. **Të akuzuarit M.N.** i shqiptohet dënim me bug në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet dhe zëvendësohet në dënim me burg.

- II. **Të akuzuarit M.S.** i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit e konform nenit 38 par.3 të KPK-së i është shëndërruar në dënim me gjobë në shumën prej 900 € (nëntëqind euro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet apo i akuzuari refuzon ta paguaj, do të ekzekutohet dënimi me burgim prej 2 (dy) muajve.

Në kuptim të nenit 60 të KPK-së të akuzuarve u shqiptohet edhe dënimi plotësues gjegjësisht marrja e sendit dhe atë dokumentet e falsifikuara-libreza e qarkullimit e shtetit të Serbisë dhe libreza e qarkullimit e Republikës së Kosovës në emër të M.N..

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare në emër të shpenzimeve penale-paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 60 €uro gjegjësishtë secili me nga 30 €, këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

1. Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1383-4/14 të dt.12.11.2014 ka ngarkuar të akuzuarit M.N. nga fshati e Epërme, komuna e Shtërpcës dhe M.S. nga Gjilani, përshkak të veprës penale në bashkëkryerje legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me neni 23 të KPK-së.

Prokuroria e shtetit aktakuzës në fjalë i ka bashkangjitur edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë e dt.20.07.2015 si dhe deklaratat e të akuzuarve të nënshkruara nga vetë ata,, mbrojtësit e tyre dhe prokurori i shtetit.

Gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë me datë 19.05.2016 në të cilën të akuzuarit, mbrojtësit e tyre të angazhuar sipas detyrës zyrtare si dhe prokurori i shtetit kanë deklaruar se përkitazi me marrëveshjen e pranimit të fajësisë, duke i propozuar gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje.

2. Vlerësimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, gjykata konstatoi se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 233 par. 18 të KPPRK-së:

- të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimin e fajësisë e kanë bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre;
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe atë nga mbrojtja e të akuzuarve dhënë gjatë procedurës hetimore, librezat e qarkullimit e shtetit të Serbisë dhe e Republikës së Kosovës, certifikata në emër të të akuzuarit të parë e dt.15.02.2012 dhe e dt.14.03.2013, polisat e sigurimit të dt.15.02.2012 dhe 14.03.2013 në emër të të akuzuarit M.N. si dhe raporti i ekspertizës i dt.20.03.2014 si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës;
- nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara me nenin 253 par.1 të KPPRK-së.

Andaj pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

3. Vlerësimi ligjor

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve M.N. dhe M.S. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës në bashkëkryerje legalizim i përmbajtjes së pa vërtetë nga neni 334 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së pasi me datën 16.02.2012 në Qendrën e Regjistrimit të automjeteve-QRA në Shtërpcë, pas një marrëveshje paraprake kanë vënë në lajthim organin kompetent për të vërtetuar një çështje të pavërtetë e paraparë të shërbej si provë në një dokument publik, në atë mënyrë që me qëllim që ti ikin zhdoganimit dhe regjistrimit të rregullt të automjetit të markës “Ford Mondeo” me numër të shasisë i vitit të prodhimit 1997, përmes dokumentit të falsifikuar librezës së qarkullimit nr..... të shtetit të serbisë në emër të të pandehurit M.N. të cilin ia kishte siguruar i pandehuri M.N., kanë arritur që të regjistrojnë automjetin në QRA në Shtërpcë të cilin automjetet e ka shfrytëzuar i pandehuri i dytë edhe pse e ka ditur se të njëjtat dokumente janë të falsifikuara.

4. Vlerësimi për dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPK-së dhe gjeti se të akuzuarit kanë arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me të cilën arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit, andaj edhe me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i përcaktuar me nenin 34 të KPK-së përkatësisht dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve janë plotësisht të justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Gjykata në kuptim të nenit 60 të KPK-së të akuzuarve u shqiptoj edhe dënimin plotësues gjegjësisht marrja e sendit dhe atë dokumentet e falsifikuara-libreza e qarkullimit e shtetit të Serbisë dhe libreza e qarkullimit e Republikës së Kosovës në emër të M.N..

Në bazë të nenit 450 të KPPRK-së gjykata të akuzuarit i obligoi që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale-paushallin gjyqësor në shumën prej 60 €, gjegjësisht secili me nga 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 dfitëzsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEGA NË SHTËRPCË
P.nr.85/2014 datë 19.05.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.